



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 130, i vitit 2019 i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurve **Eri Seiti** dhe **Aurel Alimeta**.”

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Bib Ndreca, Ardit Mustafaj dhe Alfred Konomi me vendimin Nr. 57, datë 15.10.2024 vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Eri Seiti**, për kryerjen e veprës penale të “*Grupi i strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Eri Seiti** për kryerjen e veprës penale të “*Kultivimi i bimëve narkotike*”, kryer në kuadrin e “*Grupit të strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga neni 284/1, 28/4, si edhe në bazë të nenit 334/1 i Kodit Penal, dënimin e tij me **8 (tetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
3. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve denimi i të pandehurit **Eri Seiti** me një masë të vetme prej **8 (tetë) vjet e 6 (gjashtë) burgim**.
4. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar i pandehuri përfundimisht me **5 (pesë) vite e 8 (tetë) muaj burgim**.
5. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Eri Seiti** fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.
6. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aurel Alimeta**, për kryerjen e veprës penale të “*Grupi i strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aurel Alimeta** për kryerjen e veprës penale të “*Kultivimi i bimëve narkotike*”, kryer në kuadrin e “*Grupit të strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga neni 284/1, 28/4, si edhe në bazë të nenit 334/1 i Kodit Penal, dënimin e tij me **8(tetë) vjet burgim**.
8. Ne aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve denimi i të pandehurit **Aurel Alimeta** me një masë të vetme prej **8 (tetë) vjet burgim**.
9. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar i pandehuri përfundimisht me **5 (pesë) vite dhe 4 (katër) muaj burgim**.

10. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Aurel Alimeta** fillon nga dita e ekzekutimit të masës së sigurimit datë 21.03.2024, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.
11. Bazuar në nenin 190/1/b të K.Pr.Penale, prova materiale që është 10 (dhjetë) bimë me ngjyrë jeshile, të madhësisë 15-30 cm dhe 9 (nëntë) bimë me ngjyrë jeshile, sekuestruar sipas “Procesverbali i sekuestrimit të sendeve provë materjale” me përshkrimet përkatëse i datës 16.10.2019, të asgjësohet. Provat materjale 2 qese plastike me ngjyrë blu, 1 kanaçe metalike pije energjike bosh me mbishkrimin B52, një ambalazh plastik në formën e zarfit me ngjyrë të bardhë më mbishkrimin “Dustrinë”, 1 qese plastike me ngjyrë të zezë pa mbishkrime, një bidon plastik me ngjyrë të bardhë dhe me kapak me mbishkrimin “Finalk”, një bidon plastik bosh 1.5 l, me tapë me mbishkrimin “Fanta”, sekuestruar sipas “Procesverbali i sekuestrimit të sendeve provë materjale” me përshkrimet përkatëse i datës 16.10.2019, bazuar në nenin 190/1/b të K.Pr.Penale, si sende që nuk kanë vlerë të asgjësohen.
12. Shpenzimet hetimore në masën ***** lekë si dhe ato gjyqësore (sipas procesverbalit bashkëlidhur), ju ngarkohen solidarisht të pandehurve.
13. Kundër vendimit lejohet ankim nga palët në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 15.10.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar